



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 347/1 Prishtinë 10.02. 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti **Uljan Thaqi** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Mundësia e ndërtimit të pendës në lumin Klina** ” në programin e studimeve Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Pendët janë struktura hidraulike të përbëra nga materiali mjaft i papërshkueshëm, të ndërtuara përgjatë lumit për të krijuar rezervuare akumuluese dhe për ngritjen e nivelit të ujit deri në një kuotë të caktuar. Projektimi i një pende është një nga projektet më serioze dhe më të rrezikshme të inxhinierisë së ndërtimit. Qëllimi i këtij projekti është të shqyrtojë të gjitha aspektet e realizueshmërisë së ndërtimit të një pende në fshatin Kuçicë, me qëllim të shfrytëzimit të ujit të disponueshëm, për furnizim me ujë të pijshëm në zonat e studimit dhe për veprimtari të ndryshme ekonomike, pas shqyrtimit të të gjitha kushteve (topografike, gjeologjike, hidrologjike) të kryera në vend, të cilat nevojiten për ndërtimin e pendës.

Pas shqyrtimit të të gjitha kushteve të nevojshme, është ardh në përfundim se materiali me i përshtatshëm për ndërtimin e kësaj pende është materiali rrethanor.

Ky punim jep edhe kushte në bazë të cilave bëhet përzgjedhja e tepëve të caktuara të pendëve dhe lokacionit më të përshtatshëm për vendosjen e tyre.

Rezultatet e arritura nga ky hulumtim mund të përdoren si pikënisje për fillimin e një projekti për ndërtimin e kësaj pende, e cila do të ishte shumë me rëndësi për plotësimin e nevojave për furnizim me ujë të popullatës së kësaj zone.

Fjalët kyçe: Mundësia e ndërtimit të pendës; Shqyrtimi i kushteve hidrologjike, gjeologjike, topografike; Konstruksioni i pendës.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.